

Vendim nr. 276 datë 29.10.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 29.10.2025 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 20 (E) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: ELI HYSA (SINJARI), THEMISTOKLI SINJARI, REMONDO PRIFTI, KLEDIA KOZMAI (PRIFTI), ILDA BALLA (PRIFTI), VILI SINJARI, ARJAN SINJARI, përfaqësuar nga kujdestari ligjor Genti Hysa, EVGJENI SINJARI, RINA KAZAZI (SINJARI), KOLI SINJARI, ZHANETA MAÇI (SINJARI), RAJMONDA SHQEVI (SINJARI)

OBJEKTI: Kundërshtimi i vendimeve nr. 450, datë 13.10.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; nr.103, datë 23.12.2020 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2025-169, datë 30.01.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, për shkelje flagrante të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, konkretisht nenet 29 dhe 42 të Kushtetutës, nenet 6, 13 dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Kthimi i çështjes për rigjykim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 17, 18, 29, 41, 42, 44, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); nenet 6, paragrafi 1 dhe 13 të Konventës

Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit Eli Hysa (Sinjari), Themistokli Sinjari, Sofije Prifti Sinjari (e cila ka ndërruar jetë dhe në vend të saj kërkues janë trashëgimtarët Remondo Prifti, bashkëshorti i së ndjerës, Kledia Kozmai (Prifti) dhe Ilda Balla (Prifti), të bijat e së ndjerës, Vili Sinjari, Arjan Sinjari, Evgjeni Sinjari, Rina Kazazi (Sinjari), Koli Sinjari, Zhaneta Maci (Sinjari), Rajmonda Shqevi (Sinjari), si dhe disa persona të tjerë janë trashëgimtarë ligjorë të Th.S., Dh.S., J.S. dhe Z.S. që pretendojnë pronësinë për një pasuri në zonën kadastrale nr. 8502, lagjja “30 Vjetori”, Berat. Kërkuesit pretendojnë se prona iu është kthyer me vendimin nr. 355, datë 28.02.1996 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Bashkisë Berat (*KKKP-ja, Berat*). Për regjistrimin e këtij vendimi kërkuesit i janë drejtuar me kërkesë Zyrë së Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Berat (*ZVRPP Berat*) në datën 16.07.2008. *ZVRPP-ja, Berat*, pas shqyrtimit të kërkesës, ka konstatuar se vendimi nuk ka të rregullt hartën treguese dhe për këtë u është kërkuar kërkuesve të paraqesin një plan rilevimi për të identifikuar pasurinë. Nga plani i rilevimit, i paraqitur nga kërkuesit, ka rezultuar se pasuria e paraqitur krijonte mbivendosje me pallatin dykatësh nr. 54 të regjistruar si banesë shtetërore, i privatizuar në vitet 1993-1994 nga qytetarë të ndryshëm. Po kështu, ka rezultuar se pasuria e kthyer me vendimin e sipërcituar nuk ka procesverbalin e dorëzimit të pushtetit lokal. Me urdhrin nr. 1213, datë 11.11.2008, kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtshme ka urdhëruar refuzimin e kërkesës për regjistrimin e vendimit nr. 355, datë 28.02.1996 të *KKKP-së, Berat*, urdhër ky që kërkuesit nuk e kanë ankimuar.

2. Në vijim, në vitin 2013 nga ana e kërkuesve është paraqitur padi civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, duke paditur Drejtorinë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave, Berat dhe *ZVRPP-së, Berat*, si dhe persona të tretë në gjykim, banuesit e pallatit nr. 54, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit të privatizimit të pallatit nr. 54, çregjistrimin dhe regjistrimin në emër të kërkuesve. Ajo gjykatë e ka rrëzuar padinë dhe

kërkuesit kanë paraqitur ankim. Gjykata e Apelit Vlorë, pasi ka marrë në shqyrtim ankimin, ka shpallur moskompetencën dhe dërgimin e akteve në gjykatën kompetente, atë të Apelit Administrativ. Kjo e fundit ka paraqitur kërkesë për konflikt kompetence në Gjykatë të Lartë, e cila ka disponuar se kompetente është Gjykata Administrative e Apelit. Nga ana e kësaj të fundit, për themelin e çështjes, është vendosur ndryshimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pranimi i kërkesëpadisë. Ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs nga të paditurit dhe personat e tretë, si dhe kundërrekurs nga kërkuesja Eli Hysa (Sinjari). Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë, lidhur me themelin e çështjes, ka marrë në shqyrtim rekursin e paraqitura me vendimin nr. 00-2022-1164 (243), datë 16.06.2022, si dhe ka vendosur kthimin për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë të çështjes.

3. Ndërkohë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat (*Prokuroria e Beratit*), mbi bazën e kallëzimit të bërë nga shtetasit R.M. dhe A.B. (banues në pallatin nr. 54 që krijon mbivendosje me pronën e pretenduar të kërkuesve), ka regjistruar procedimin penal nr. 332 të vitit 2019, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal (KP) ndaj kërkuesve dhe disa personave të tjerë të familjes Sinjari, lidhur me vendimin nr. 355, datë 28.02.1996 të KKKP-së, Berat. Kallëzuesit gjithashtu kanë paraqitur si provë edhe një akt ekspertimi grafik me nr. akti 42, datë 29.03.2019, i kryer nga një ekspert kriminalist për të vërtetuar pretendimet e tyre për falsifikimin e vendimit nr. 355, datë 28.02.1996 të KKKP-së, Berat.

4. Nga ana e Prokurorisë së Beratit janë kryer veprime hetimore, si: marrja në pyetje e personave që kanë dijeni, korrespondenca me organe të ndryshme shtetërore dhe është kërkuar ekspertimi grafik i vendimit të KKKP-së, Berat nga Instituti i Policisë Shkencore, nga ku kanë rezultuar ndërhyrje në aktin e ekspertuar. Për këto hetime, Prokuroria e Beratit ka konkluduar se janë konsumuar elemente të veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve” të parashikuar nga neni 186 i KP-së, por në kushtet kur dokumenti është prodhuar në vitin 1996 dhe kanë kaluar 23 vjet deri në momentin e kallëzimit, rezulton se ndjekja penale është parashkruar. Për këto arsye, Prokuroria e Beratit ka paraqitur kërkesë në gjykatë për pushimin e çështjes penale nr. 332 të vitit 2019, bazuar në nenet 328, pika 1, shkronja “d” dhe 329/a të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 450, datë 13.10.2020, ka vendosur pushimin e çështjes penale. Ajo gjykatë ka arsyetuar se referuar provave të paraqitura në gjykim, pavarësisht se ka rezultuar se vendimi nr. 355, datë 28.02.1996 i KKKP-së, Berat dhe planimetria shoqëruese janë të falsifikuara, në kushtet kur ushtrimi ndjekjes penale është parashkruar sipas nenit 66 të KP-së, çështja duhet të pushohet, referuar nenit 328, pika 1,

shkronja “d”, të KPP-së. Ndaj këtij vendimi kanë ushtruar ankim kërkuesit dhe apel kundërshtues kallëzuesit.

6. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 103, datë 23.12.2020, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit gjyqësor nr. nr. 450, datë 13.10.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat duke e konsideruar atë të drejtë dhe duke konkluduar se veprimet hetimore të Prokurorisë Berat ishin shteruese. Mbi rekursin e paraqitur nga kërkuesja Eli Hysa (Sinjari), Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-169, datë 30.01.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se ai nuk përmbante ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

7. Në datën 18.07.2025 kërkuesit kanë paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 30.07.2025. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr.8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesve

8. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u janë cenuar:

8.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

8.1.1. *Parimit të paanshmërisë*, pasi gjykata e apelit veproi si noter i vendimit të gjykatës së shkallës së parë pa analizuar provat, pa ballafaquar palët dhe pa dhënë një arsyetim ligjor, duke mos marrë parasysh as kërkesat thelbësore të mbrojtjes për hetim shtesë, as dëshmitarët e kërkuar dhe as sqarim për ekspertizën e pabazuar.

8.1.2. *Së drejtës së mbrojtjes të lidhur me parimin e barazisë së armëve*, pasi asnjë nga të dyshuarit e familjes Sinjari nuk janë thirrur ose pyetur nga ana e Prokurorisë së Beratit, duke u bërë objekt të një vendimi që i stigmatizon si të lidhur me një vepër penale, duke mos u dhënë të drejtën për t’u mbrojtur. Gjithashtu, shkelje të kësaj të drejte përbën edhe refuzimi për të kryer riekspertim.

8.1.3. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi vendimet nuk përmbajnë analizë të plotë të fakteve, nuk marrin në konsideratë rrethanat historike dhe as peshën e provave të mbrojtjes, duke sjellë në këtë mënyrë një shqyrtim joreal të çështjes.

- 8.2. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, pasi familjes Sinjari i është bërë një trajtimi i ndryshëm nga qytetarët e tjerë që ndodhen në të njëjtin pozicion juridik.
- 8.3. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi vendimi i formës së prerë i Gjykatës Administrative të Apelit nuk u ekzekutua dhe u sfidua me mjete të jashtëligjshme, duke bllokuar ekzekutimin përmes akuzave penale artificiale.
- 8.4. *E drejta e pronës*, pasi vendimet gjyqësore në vend që të mbrojnë të drejtën e pronës së fituar me ligj, kanë lejuar që ajo të vihet në pikëpyetje për shkak të një procesi të padrejtë. Në këtë mënyrë na është shkelur e drejta e pronës e mbrojtur nga Kushtetuta dhe KEDNJ-ja.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuarve

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Lidhur me legjitimitetin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individ duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen konkrete, Kolegji evidenton se kërkuarët kanë kundërshtuar procesin gjyqësor penal, të përmbyllur në të tria shkallët e gjyqësorit, që ka vendosur për pushimin e procedimit penal për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, ku vetë ata ishin të kallëzuar, me pretendimin se u janë cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor dhe e drejta e pronës. Për rrjedhojë, rezulton se nga pikëpamja procedurale kërkuarët e justifikojnë interesin e tyre në çështjen e parashtruar, pasi kanë qenë palë e kallëzuar në procesin gjyqësor ku janë dhënë vendimet e kundërshtuara.

11. Për sa i përket aspektit substancial të legjitimitetit *ratione personae*, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individ, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë

ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Kolegji çmon se kërkuesit duhet të justifikojnë interesin kushtetues për çështjen e parashtruar përpara Gjykatës, pra se cenimi i të drejtave themelore prej vendimeve gjyqësore të kundërshtuara është vetjak, i drejtpërdrejtë dhe real.

12. Në rastin konkret, vërehet se procesi gjyqësor objekt i ankimit kushtetues individual ka të bëjë, në thelb, me kundërshtimin e mënyrës së pushimit të procedimit penal për kallëzimin e bërë ndaj tyre nga dy shtetas, për veprën penale të parashikuar nga nenit 186 i KP-së, lidhur me titullin e tyre të pronësisë: vendimin nr. 355, datë 28.02.1996 të KKKP-së, Berat. Pas hetimeve të bëra prokuroria ka konkluduar se vendimi nr. 355, datë 28.02.1996 i KKKP-së, Berat është i falsifikuar, megjithatë në kushtet kur ndjekja penale është parashkruar për shkak të periudhës së gjatë, referuar nenit 328, pika 1, shkronja “d”, të KPP-së, ka kërkuar pushimin e çështjes. Ky përfundim i prokurorisë është kundërshtuar nga kërkuesit, të cilët kanë kërkuar kthimin e akteve Prokurorisë së Beratit për thellimin e hetimeve dhe në alternativë pushimin e gjykimit, për shkak se fakti nuk ekziston. Të tria gjykatat e zakonshme, mbi ankimin e kërkuesve kanë konsideruar të drejtë vendimmarrjen e prokurorit, duke vendosur pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

13. Paralelisht me kallëzimin penal, Kolegji konstaton se nga kërkuesit është ngritur padi civile (por që u ka kaluar për kompetencë lëndore gjykatave administrative) ndaj disa institucioneve shtetërore ku si palë të treta janë thirrur edhe kallëzuesit së bashku me banorë të tjerë të pallatit dykatësh. Siç rezulton nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë, ky gjykim është përmbyllur në këtë gjykatë me vendimin nr. 00-2022-1164 (243), datë 16.06.2022, duke e kthyer çështjen për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, për shkak të ndërtimit të gabuar të ndërgjyqësisë së detyrueshme. Aktualisht nuk disponohet informacion për vijimin e çështjes administrative. Duke mbajtur parasysh këto rrethana, si dhe pretendimet në ankimin kushtetues individual, Kolegji vëren se, në thelb, kërkuesit kërkojnë të mbrojnë të drejtën e pronës private, pasi pushimi i gjykimit penal i ndikon në procesin administrativ të vënë në lëvizje nga ata.

14. Kolegji evidenton se procesi penal ka në objekt hetimin dhe eventualisht gjykimin e veprës penale dhe të autorit/ëve të saj. Në rastin konkret, gjykimi kushtetues është vënë në lëvizje për vendimmarrje të lidhura me procesin penal nga kërkuesit, duke kërkuar mbrojtjen e të drejtës së pronës, fakt ky që nuk lidhet dhe nuk justifikon interesin real, vetjak dhe të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar, në kuptimin që këto vendime të kundërshtuara të

ndërhyjnë drejtpërdrejt te një e drejtë themelore e viktimës në një proces tjetër. Nën këtë optikë, Kolegji vlerëson se procesit penal i kundërshtuar në gjykimin kushtetues nuk e bën atë të ndikojë automatikisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin administrativ për shqyrtimin në themel të mosmarrëveshjes për pronën objekt konflikti. Po kështu, në rrethanat e rastit konkret, procesi penal ku kërkuesit janë të kallëzuar duket se, nga njëra anë, as nuk mund të sjellë pasojat juridike që kërkuesit synojnë dhe, nga ana tjetër, as nuk i kushtëzon ata në përdorimin e mjeteve ligjore për mbrojtjen e të drejtave substanciale (civile) që ata pretendojnë se u janë shkelur, në gjykatat administrative të faktit. Kolegji vlerëson se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për pushimin e çështjes penale ndaj kërkuesve nuk përfaqëson një vendim “tipik” përfundimtar, të formës së prerë dhe, për më tepër, ky vendim nuk klasifikohet si i detyrueshëm për procesin administrativ, referuar pikës 2 të nenit 70 të KPP-së dhe, si i tillë, nuk sjell pasoja për kërkuesit.

15. Duke mbajtur parasysh edhe për sa më sipër, rezulton se prova e procesit penal nuk mund të merret e mirëqenë në procesin civil, për arsye se në këto lloj procesesh prova formohet përmes debatit të realizuar mes palëve, në respektim të parimit të kontradiktoritetit. Bazuar në këto konsiderata, vlerësohet se pretendimet e kërkuesve nuk janë të mjaftueshëm për të justifikuar interesin e tyre në çështjen kushtetuese të parashtruar, në kuptimin që vendimet dhe procesi i kundërshtuar të sjellin pasoja reale dhe të drejtpërdrejta në të drejtat dhe liritë themelore individuale të tyre. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se në rastin konkret kërkuesit, nga pikëpamja substanciale, nuk justifikojnë interesin e drejtpërdrejtë, ndaj nuk legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës.

16. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

17. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.